



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“VETERINARI”

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

N-IV-25

Tiranë, 2025

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi	4
Kohëzgjatja	4
Niveli	4
Qëllimi	4
Kriteret e përgjithshme të pranimit	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit	4
Ofruesit	4
Data e validimit	4
Data e miratimit	4
Variantet e mëparshme	4
Struktura e kualifikimit	5
Kompetenca të përgjithshme	5
Njësitë e të nxënit të kualifikimit profesional	5
NjN-13-IV-0447-25 Planifikimi dhe organizimi i punës në veterinari	5
Rezultatet e të nxënit në njohuri	5
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	6
Kriteret e vlerësimit	6
NjN-13-IV-0448-25 Bazat e anatomisë, fiziologjisë dhe patologjive në kafshë	7
Rezultatet e të nxënit në njohuri	7
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	7
Kriteret e vlerësimit	8
NjN-13-IV-0449-25 Higjiena, shëndeti i kafshëve dhe mirëqenia e tyre	8
Rezultatet e të nxënit në njohuri	8
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	9
Kriteret e vlerësimit	9
NjN-13-IV-0450-25 Mikroorganizmat, infeksioni, sëmundjet infektive dhe profilaksia e tyre	9
Rezultatet e të nxënit në njohuri	9
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	10
Kriteret e vlerësimit	10
NjN-13-IV-0451-25 Sëmundjet e brendshme dhe diagnoza e tyre	11
Rezultatet e të nxënit në njohuri	11
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	12
Kriteret e vlerësimit	12
NjN-13-IV-0452-25 Kujdesi për shëndetin riprodhues të kafshëve	12
Rezultatet e të nxënit në njohuri	12
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	13
Kriteret e vlerësimit	14
NjN-13-IV-0453-25 Kujdesi për të ushqyerit e kafshëve	15
Rezultatet e të nxënit në njohuri	15
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	15
Kriteret e vlerësimit	15
NjN-13-IV-0454-25 Kirurgjia profilaktike me procedura kirurgjikale	16
Rezultatet e të nxënit në njohuri	16

Rezultatet e të nxënit në njohuri	16
Kriteret e vlerësimit.....	16
NjN-13-IV-0455-25 Administrimi i preparateve mjekësore veterinare	17
Rezultatet e të nxënit në njohuri	17
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	18
Kriteret e vlerësimit.....	18
NjN-13-IV-0456-25 Kampionimi për analiza laboratorike dhe kërkim shkencor	18
Rezultatet e të nxënit në njohuri	18
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	18
Kriteret e vlerësimit.....	18
NjN-13-IV-0457-25 Kontrolli i produkteve me origjinë shtazore.....	19
Rezultatet e të nxënit në njohuri	19
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	20
Kriteret e vlerësimit.....	20
NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere	20
Rezultatet e të nxënit në njohuri	20
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	21
Kriteret e vlerësimit.....	21
NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale	21
Rezultatet e të nxënit në njohuri	22
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	22
Kriteret e vlerësimit.....	22
NjN-13-IV-0458-25 Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në veterinari	23
Rezultatet e të nxënit në njohuri	23
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	23
Kriteret e vlerësimit.....	23
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse.....	24
Modalitetet e vlerësimit	24
Informacion shtesë	25
Shënim.....	25

Emërtimi i kualifikimit	“Veterinari”			Kodi
Kohëzgjatja	4200-6000 orë nacionale	Niveli	Niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK	N-IV-25
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Veterinari” niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është të përgatisë punonjës me kualifikim në fushën përkatëse, si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet që ofrohet kualifikimi profesional “Veterinari”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që: <ul style="list-style-type: none"> – kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar; – janë në kushte shëndetësore që e lejojnë kryerjen e detyrës për përballimin e kërkesave të këtij niveli të arsimit profesional; – pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Veterinari”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën e aftësisë profesionale dhe Supplementin përkatës, të teknikut të mesëm në këtë drejtim profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky kualifikim profesional i jep individit mundësi t'i drejtohet tregut të punës si teknik i mesëm në menaxhimin e ndërmarrjeve/operatorë të Biznesit Ushqimor (OBU), teknik ndërzimi, teknik në klinikë veterinarë të kafshëve të shoqërimit, teknik në thertore, ndihmës në farmacitë veterinarë ose veprimtari të tjera në fushën e veterinarisë. Individit mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual ose familjar në fushën e prodhimeve blegtorale, gjithashtu, ai/ajo mund të punësohet në shërbimin veterinar shtetëror. Me përfundimin e këtij niveli, individit ka mundësi për të fituar diplomën e “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesëm ose universitare.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional			
Data e validimit	Dhjetor 2025			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	N-III-11, N-IV-17; N-IV-21			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “**Veterinari**”, niveli IV në KSHK referuar nivelit IV të KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë, shprehitë profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë efçiente me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
- Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

NjN-13-IV-0447-25 Planifikimi dhe organizimi i punës në veterinar

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të listojë parimet e mjekësisë veterinarë;
2. Të shpjegojë filozofinë “Një botë, një shëndet”;
3. Të përshkruajë rolin e sektorit të shërbimit veterinar në Shqipëri;
4. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të kuadrit ligjor në fushën e shërbimit veterinar;
5. Të përshkruajë zhvillimet në fushën e veterinarisë;
6. Të listojë llojet e dokumentacionit teknik në fushën e Shërbimit Veterinar;
7. Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të teknologjive bashkëkohore dhe mjeteve digjitale;
8. Të shpjegojë rëndësinë e menaxhimit, planifikimit, organizimit dhe monitorimit të biznesit;
9. Të shpjegojë rëndësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore;
10. Të përshkruajë mënyrat e planifikimit të punës ditore, javore dhe mujore;
11. Të shpjegojë mënyrën e organizimit të punës dhe ndarjes së detyrave, sipas prioriteteve;
12. Të përshkruajë rëndësinë e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
13. Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të materialeve, mjeteve, instrumenteve dhe pajisjeve të punës;
14. Të shpjegojë mënyrën e përdorimit të mjeteve, materialeve, instrumenteve dhe pajisjeve të punës, sipas funksionit të tyre;
15. Të shpjegojë mënyrat e kontrollit të gatishmërisë për punë të mjeteve, instrumenteve dhe pajisjeve të punës;
16. Të përshkruajë mënyrat e pastrimit, dezinfektimit dhe mirëmbajtjes së mjeteve, instrumenteve dhe pajisjeve dhe vendit të punës;
17. Të shpjegojë mënyrat e planifikimit të kohës dhe radhës së punës, sipas prioriteteve;
18. Të përshkruajë rëndësinë e bashkëpunimit me eprorët dhe specialistë të tjerë;
19. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të hapave dhe afateve të realizimit të një shërbimi;
20. Të përshkruajë rëndësinë e dokumentimit dhe raportimit për proceset e punës.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të organizojë punën për realizimin e veprimtarive në fushën e veterinarisë;
2. Të menaxhojë burimet materiale dhe njerëzore për realizimin e proceseve të punës;
3. Të dokumentojë dhe raportojë për punën e kryer;
4. Të përdorë teknologjitë bashkëkohore dhe mjetet digjitale në fushën e veterinarisë.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton parimet e mjekësisë veterinarë, sipas legjislacionit në fuqi;
- Kryen planifikimin sipas përparësive të punës;
- Kryen planifikimin për veprimtaritë sipas afateve përkatëse;
- Përcakton proceset e punës sipas procedurave teknike;
- Monitoron zbatimin e detyrave sipas radhës dhe përparësive të punës;
- Planifikon saktë kohën e proceseve të punës;
- Planifikon burimet njerëzore sipas proceseve të punës;
- Menaxhon burimet njerëzore sipas proceseve të punës dhe kualifikimeve përkatëse;
- Planifikon burimet materiale sipas planit të prodhimit;

- Menaxhon burimet materiale sipas proceseve të punës;
- Përzgjedh mjetet, instrumentet, pajisjet dhe materialet e punës, sipas proceseve përkatëse;
- Bashkëpunon me specialistë të tjerë sipas rregullores së brendshme dhe proceseve të punës;
- Mbikëqyr realizimin e detyrave sipas planit të prodhimit;
- Mbikëqyr pastrimin dhe sistemimin e vendit të punës sipas rregullores së brendshme;
- Mbikëqyr pastrimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, mjeteve dhe pajisjeve digjitale sipas Manualeve përkatëse;
- Mbikëqyr gatishmërinë e bazës materiale sipas proceseve të punës dhe Manualeve përkatëse;
- Mbikëqyr organizimin e vendit të punës në mënyrë ergonomike;
- Dokumenton kryerjen e veprimtarive sipas formularëve/formate përkatëse;
- Përdor teknologjinë digjitale në menaxhimin e fermës sipas manualeve të përdorimit;
- Përdor rregullisht pajisjet digjitale në procese të ndryshme të punës;
- Krijon databazën e të dhënave për veprimtaritë në fermë;
- Raporton tek eprori për realizimin e detyrave në mënyrë periodike sipas rregullores së brendshme.

NjN-13-IV-0448-25 Bazat e anatomisë, fiziologjisë dhe patologjive në kafshë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë marrëdhëniet e ngushta midis anatomisë dhe fiziologjisë;
2. Të përshkruajë indet që përbëjnë organet e trupit, ndërtimin dhe funksionet e tyre;
3. Të përshkruajë pjesët përbërëse dhe përdorimin e mikroskopit;
4. Të përshkruajë rajonet kryesore anatomike të trupit dhe nomenklaturën bazë anatomike;
5. Të përshkruajë sistemet: muskuloskeletor, qarkullimit të gjakut, tretës. respirator, urogenital, mbulues (integumentar: lëkura, qimet, thonjtë, gjëndrat e djersës dhe yndyrës), endokrin, nervor, receptorët dhe organet shqisore;
6. Të përshkruajë treguesit klinikë normalë në kafshë;
7. Të përshkruajë sjelljen (etologjia) e kafshëve në situata të veçanta;
8. Të përshkruajë sëmundjen si proces;
9. Të rendisë shkaqet e sëmundjeve në kafshë (etiologjia);
10. Të përshkruajë proceset patologjike në organizëm, shkaqet dhe shenjat e tyre në kafshë;
11. Të përshkruajë tumoret, shkaqet dhe klasifikimin e tyre;
12. Të përshkruajë çfarë është inflamacioni, shenjat, procesin e zhvillimit dhe llojet e tij;
13. Të përshkruajë patologjitë kryesore të sistemeve (kardiovaskular, të aparatit të tretjes, të sistemit nervor, të aparatit uro-gjinor etj.);
14. Të përshkruajë mënyrën, vendin dhe rregullat e kryerjes së nekropsisë në kafshë.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të identifikojë sistemet, funksionet, elementët e tyre;
2. Të identifikojë patologjitë në sistemet e ndryshme të trupit.

Kriteret e vlerësimit

- Përcakton pjesët përbërëse të mikroskopit sipas përdorimit të tyre;
- Dallon indet në organet e trupit, sipas llojit dhe ndërtimit të tyre;
- Përcakton rajonet kryesore anatomike të trupit;
- Përcakton elementët e sistemit skeletor, sipas rajoneve përkatëse;
- Përcakton saktë muskujt sipas rajoneve;
- Përcakton organet e aparatit tretës, sipas specieve të kafshëve;
- Përcakton pjesët e sistemit nervor në kafshë;
- Përcakton saktë organet e qarkullimit të gjakut;
- Identifikon elementet qelizorë të gjakut;
- Përcakton nyjet limfatike rajonale;
- Përcakton organet e aparatit të frymëmarrjes;
- Përcakton organet e sistemit urinar;
- Përcakton vendndodhjen e gjëndrave me sekrecion të brendshëm;
- Përcakton organet e riprodhimit sipas seksit;
- Përcakton saktë organet e shqisave;
- Identifikon shtresat e lëkurës dhe anekset e saj;
- Përcakton elementët përbërës të thundrës;
- Krahason treguesit klinikë normalë, sipas specieve të kafshëve;
- Identifikon sjelljen (etologjinë) e kafshëve në situata të veçanta;
- Identifikon shenjat e patologjive në organizmin e kafshëve;
- Përcakton saktë llojet e inflamacionit;
- Përcakton patologjitë në sisteme të ndryshme të organizimit (kardiovaskular, të aparatit të tretjes, të sistemit nervor, të aparatit uro-gjinor etj.);
- Zbaton procedurat e nekropsisë sipas radhës në kafshë.

NjN-13-IV-0449-25 Higjiena, shëndeti i kafshëve dhe mirëqenia e tyre

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë mënyrën e kryerjes së përkujdesjes për pastërtinë fizike të kafshëve;
2. Të përshkruajë mënyrën e kryerjes së higjienizimit të mjeteve mjekësore pas përdorimit të tyre (stetoskopë, termometra, shiringa etj.);
3. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të cilësisë së ujit dhe enëve të tij;
4. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të ushqimeve dhe vendeve të ruajtjes së tyre;
5. Të përshkruajë masat profilaktike të përgjithshme dhe të veçanta;
6. Të shpjegojë rëndësinë e karantinimit dhe izolimit të kafshëve të sëmura ose të dyshimta;
7. Të shpjegojë rëndësinë e strehimit dhe mikroklimës në stallë, sipas llojit të kafshëve, kategorisë dhe gjendjes fiziologjike;
8. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes dhe regjistrimit të gjendjes higjienike të kafshëve dhe mjedisit;
9. Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së gjendjes shëndetësore të kafshëve dhe të ndërhyrjeve në rastet emergjente;
10. Të shpjegojë rëndësinë e procesit të identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve;

11. Të listojë mënyrat dhe teknikat e matrikullimit të kafshëve;
12. Të shpjegojë rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të kafshëve;
13. Të përshkruajë çfarë është mirëqenia psikologjike të kafshët dhe sjelljet e tyre normale;
14. Të përshkruajë çfarë është eutanazia veterinarë të kafshët e sëmura;
15. Të shpjegojë rëndësinë e raportimit në kohë të shenjave të sëmundjeve;
16. Të shpjegojë rëndësinë e gjurmueshmërisë shëndetësore të kafshëve;
17. Të përshkruajë elementët e biosigurisë në fermë dhe rëndësinë e tyre.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të zbatojë procedurat për higjienizimin e trupit të kafshës dhe mjedisit të tyre;
2. Të kontrollojë higjienën e ujit, ushqimeve dhe mjeteve të mjeljes;
3. Të zbatojë procedurat e karantinimit, izolimit dhe raportimit të kafshëve të sëmura dhe të dyshimta.
4. Të zbatojë teknikat e identifikimit, regjistrimit dhe matrikullimit në specie;

Kriteret e vlerësimit

- Kryen higjienizimin fizik të kafshëve sipas procedurës përkatëse;
- Mbikëqyr treguesit e mikroklimës (temperatura, gaze, lagështia, ventilimi etj.);
- Kontrollon higjienën e ujit dhe enëve të tij;
- Kryen kontrollin e ushqimit për prani të mykut, erës së keqe, datës së skadimit etj.;
- Kryen kontrollin e ushqimit në stallë dhe në vendin e depozitimit të tij;
- Kontrollon higjienën e mjeteve dhe pajisjeve të mjeljes;
- Asiston/identifikon/regjistron kafshët, sipas procedurës përkatëse;
- Kryen matrikullimin e kafshëve me teknika të ndryshme;
- Kujdeset për minimizimin e faktorëve stresantë në kafshë;
- Mbron të drejtat dhe liritë e kafshëve (liria ndaj etjes dhe urisë, liria e diskomfortit, liria ndaj vuajtjes, liria e sjelljes normale në habitat, liria e stresit etj.);
- Zbaton saktë procedurat e karantinimit të kafshëve të sëmura dhe atyre të dyshimta, sipas legjislacionit në fuqi;
- Zbaton saktë procedurat izolimit të kafshëve të sëmura dhe atyre të dyshimta, sipas legjislacionit në fuqi;
- Mbikëqyr kafshët e sëmura dhe të dyshimta, sipas rasteve konkrete;
- Raporton në kohë për kafshët e sëmura dhe të dyshimta;
- Kryen periodikisht higjienizimin e mjediseve të brendshme dhe jashtme të kafshëve: dezinfektimin e stallave/kafazeve, qendrave të trajtimit, heqjen dhe menaxhimi i plehut/feçes dhe urinës ajrimin e ambienteve të mbyllura etj.;
- Zbaton protokollet e biosigurisë në fermë.

NjN-13-IV-0450-25 Mikroorganizmat, infeksioni, sëmundjet infektive dhe profilaksia e tyre

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të klasifikojë grupet e mikroorganizmave;

2. Të përshkruajë llojet kryesore të mikroorganizmave patogjenë dhe rolin e tyre në lindjen e infeksionit;
3. Të shpjegojë çfarë është infeksioni, burimet, shkaktarët dhe sëmundjet infektive;
4. Të listojë rrugët e hyrjes së mikroorganizmave patogjenë në organizëm;
5. Të përshkruajë barrierat mbrojtëse të organizmit ndaj mikroorganizmave patogjenë;
6. Të listojë rrugët e eliminimit të mikroorganizmave nga organizmi;
7. Të përshkruajë format e shfaqjes së sëmundjeve infektive;
8. Të përshkruajë llojet e vaksinave në kafshë, afatet e aplikimit si dhe mënyrat e vaksinimit;
9. Të përshkruajë çfarë është imuniteti dhe llojet e tij (alergjia, anafilaksinë, antigenët dhe antitruapat specifikë);
10. Të listojë mjetet kryesore të laboratorit të shëndetit të kafshëve;
11. Të përshkruajë shenjat klinike të sëmundjeve infektive në kafshë;
12. Të përshkruajë ndryshimet makroskopike, në inde dhe organe për sëmundjet kryesore infektive;
13. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të skemave të mjekimit të sëmundjeve kryesore infektive në kafshë;
14. Të përshkruajë konceptin e profilaksisë, rëndësinë e zbatimit të planit profilaktik të përgjithshëm dhe të veçantë për sëmundjet infektive në kafshë;
15. Të shpjegojë rëndësinë e gjurmimit për sëmundjet infektive dhe zbatimin e hapave përkatëse.
16. Të përshkruajë rëndësinë dhe objektin e Parazitologjisë veterinarë, morfologji dhe ciklin biologjik të shkaktarëve të sëmundjeve parazitare;
17. Të përshkruajë shenjat kryesore klinike të sëmundjeve parazitare në kafshë;
18. Të përshkruajë ndryshimet makroskopike të kafshëve të infestuara dhe metodat e diagnostikimit të sëmundjeve parazitare në kafshët e gjalla dhe të ngordhura;
19. Të përshkruajë masat për parandalimin dhe mjekimin e kafshëve me sëmundjet parazitare.
20. Të përshkruajë konceptin e profilaksisë dhe masat për parandalimin e sëmundjeve infektive;
21. Të shpjegojë llojet e dezinfektantëve, faktorët, kushtet përcaktues të shkallës së veprimit dhe përdorimet e tyre në veterinarë;
22. Të përshkruajë mënyrat e asgjësimit të kafshëve të ngordhura, materialeve dhe mbeturinave shtazore.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përcaktojë shkaqet dhe shenjat klinike të sëmundjeve infektive dhe parazitare;
2. Të zbatojë protokollin e mjekimit, të përcaktuar nga mjeku veterinar, për sëmundjet infektive dhe parazitare;
3. Të zbatojë kalendarin e vaksinimeve, dezinfektimin, deratizimin dhe dezinfektimin;
4. Të kryejë dokumentimin dhe raportimin të vaksinimit, dezinfektimin, deratizimin dhe dezinfektimin.

Kriteret e vlerësimit

- Përdor mjetet kryesore në një laborator të shëndetit të kafshëve;
- Identifikon në kohë shenjat klinike të sëmundjeve infektive, joinfektive;

- Përdor saktë alergjenët dhe biopreparatet për diagnostikimin e sëmundjeve infektive;
- Vrojton/përcakton ndryshimet makroskopike në organe për sëmundjet kryesore infektive;
- Identifikon në kohë shenjat e sëmundjeve zoonotike;
- Raporton në kohë për shfaqjen e sëmundjeve zoonotike tek mjeku dhe shërbimi veterinar shtetëror;
- Kryen mjekimin e sëmundjeve infektive në kafshë, sipas protokollit;
- Zbaton planin profilaktik të përgjithshëm dhe të veçantë për sëmundjet infektive në kafshë, sipas kalendarit përkatës;
- Kryen vaksinimin e kafshëve sipas manualeve përkatëse;
- Asiston gjurmimin për sëmundjet infektive duke zbatuar hapat përkatës;
- Identifikon shenjat klinike të sëmundjeve parazitare në kafshë, me metodat përkatëse;
- Dallon ndryshimet makroskopike të organeve të infestuara;
- Zbaton kalendarin e masave për parandalimin e sëmundjeve parazitare në kafshë;
- Kryen mjekimin e kafshëve me sëmundjet parazitare, sipas udhëzimeve të mjekut veterinar;
- Kryen dezinfektimin, deratizimin dhe dezinfektimin (DDD), sipas procedurave dhe manualeve përkatëse;
- Raporton në kohë nevojën për asgjësimin e kafshëve të gjalla dhe të ngordhura/vdekura;
- Asiston në zbatimin e procedurave të asgjësimit të kafshëve të vdekura/të ngordhura;
- Kryen vaksinimin në kafshë të ndryshme, sipas udhëzimeve dhe kalendarit përkatës;
- Dokumenton kryerjen e vaksinimit, dezinfektimin, deratizimin dhe dezinfektimin;
- Raporton realizimin e vaksinimit, dezinfektimin, deratizimin dhe dezinfektimin.

NjN-13-IV-0451-25 Sëmundjet e brendshme dhe diagnoza e tyre

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë shenjat klinike kryesore të sëmundjeve të sistemeve/aparateve të organizmit;
2. Të përshkruajë parimet e mjekimit në kafshët e sëmura sipas sistemeve/aparateve të organizmit;
3. Të rendisë shkaqet e sëmundjeve metabolike, mjekimin dhe masat profilaktike për parandalimin e tyre;
4. Të përshkruajë shkaqet, shenjat klinike në kafshët e helmuara, mjekimin dhe masat për parandalimin e tyre;
5. Të përshkruajë sëmundjet e kafshëve të reja, shenjat klinike, mjekimin dhe masat për parandalimin të tyre;
6. Të përshkruajë sëmundjet kryesore të kafshëve të shoqërimit, shenjat klinike, mjekimi dhe masat për parandalimin të tyre;
7. Të përshkruajë sëmundjet e lëkurës dhe të organeve të shqisave;
8. Të përshkruajë habitusin në kafshë;
9. Të përshkruajë konceptin anamnezë dhe rëndësinë e marrjes së saj;
10. Të përshkruajë metodat e kontrollit klinik të kafshës përmes instrumenteve përkatëse.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përcaktojë shenjat klinike kryesore të sëmundjeve të sistemeve/aparateve të organizmit;
2. Të zbatojë protokollet e mjekimit në kafshët e sëmura (sëmundje të brendshme, metabolike, helmime etj.);
3. Të kryejë mjekimin e sëmundjeve në kafshët e reja, bazuar në shenjat klinike;
4. Të zbatojë masat për parandalimin e sëmundjeve në kafshët e reja;
5. Të kontrollojë habitusin në kafshë të ndryshme;
6. Të zbatojë procedurat për marrjen e anamnezës së kafshës.

Kriteret e vlerësimit

- Dallon shenjat klinike kryesore të sëmundjeve sipas sistemeve/aparateve të organizmit;
- Zbaton parimet e mjekimit në kafshët e sëmura sipas sistemeve/aparateve të organizmit;
- Kryen mjekimin e sëmundjeve metabolike sipas rekomandimeve të mjekut veteriner;
- Zbaton masat profilaktike për parandalimin e sëmundjeve metabolike sipas udhëzimeve të specialistit;
- Identifikon kafshët e helmuara sipas shenjave klinike;
- Mjekon kafshët e helmuara sipas procedurave përkatëse;
- Interpreton shenjat klinike të sëmundjeve në kafshët e reja sipas sistemeve/aparateve të organizmit;
- Kryen mjekimin e sëmundjeve në kafshët e reja sipas rastit dhe udhëzimeve të mjekut veteriner;
- Kryen mjekimin e kafshëve të shoqërimit sipas procedurave përkatëse;
- Kryen mjekimin e sëmundjeve të lëkurës dhe të organeve të shqisave sipas udhëzimeve të mjekut veteriner;
- Kontrollon habitusin e kafshëve të ndryshme sipas gjendjes shëndetësore;
- Grupon të dhënat e anamnezës bazuar në informacionin e dhënë nga pronari/shoqëruesi i kafshës;
- Kryen mjekimin medikamentoz në kafshë sipas udhëzimeve të mjekut veteriner;
- Kryen kontrollin klinik të kafshës me metodat dhe instrumentet përkatëse sipas sistemeve/aparateve të organizmit.

NjN-13-IV-0452-25 Kujdesi për shëndetin riprodhues të kafshëve

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë konceptin e pjekurisë seksuale dhe asaj trupore;
2. Të shpjegojë ciklin seksual, rolin e hormoneve, periudhat dhe karakteristikat e tij tek kafshët dhe faktorët që ndikojnë në shëndetin riprodhues;
3. Të përshkruajë mënyrat dhe teknikat për monitorimin e estrusit (afshit);
4. Të shpjegojë nxitjen, sinkronizimin dhe preparatet hormonale për riprodhim në kafshë;
5. Të shpjegojë procesin e ndërimit, llojet e tij dhe rëndësinë e njohjes së reflekseve seksuale;

6. Të shpjegojë metodat e ndërzimit artificial, rëndësinë dhe avantazhet e tij si dhe mjetet dhe instrumentet për realizimin e tij;
7. Të shpjegojë procesin e fekondimit, zhvillimit embrional dhe funksionet e placentës në kafshë;
8. Të shpjegojë ndryshimet anatomike, fiziologjike dhe periudhën e barrsmërisë në kafshë;
9. Të përshkruajë metodat e diagnostikimit të barrsmërisë;
10. Të përshkruajë shenjat parajlmëruese, procesin e pjelljes dhe fazat e tij;
11. Të shpjegojë veçoritë e pjelljes në kafshë të ndryshme, kujdesin dhe ndihmën për kafshën gjatë pjelljes;
12. Të shpjegojë trajtimin e kafshëve pas pjelljes dhe të porsalindurve;
13. Të shpjegojë mënyrën e shumimit në shpendë dhe çeljen e zogjve në inkubator;
14. Të shpjegojë rritjen dhe shumimin e krimbit të mëndafshit, bletës dhe peshqve;
15. Të listojë shenjat e dhimbjeve të parakohshme, në kafshët barrsë dhe shkaqet e tyre;
16. Të listojë llojet e dështimeve në kafshët dhe shkaqet e tyre;
17. Të shpjegojë masat higjieno-sanitare për mbrojtjen e shëndetit riprodhues të kafshëve;
18. Të shpjegojë shenjat klinike dhe metodat e ndërhyrjes në pjelljet e vështira në kafshë;
19. Të shpjegojë shkaqet, shenjat dhe mjekimin për prolapsin e vaginës dhe mitrës në kafshë;
20. Të shpjegojë shkaqet, shenjat dhe mjekimin për mbetjet e shtratit në kafshë;
21. Të shpjegojë shkaqet, shenjat klinike, mjekimin dhe masat parandaluese në patologjitë e organeve gjinore;
22. Të identifikojë shkaqet e shterpësisë të përkohshme dhe të përhershme në kafshë;
23. Të përshkruajë faktorët që ndikojnë në shëndetin e gjirit;
24. Të përshkruajë mastitet klinike dhe subklinike, shkaqet, shenjat klinike, mjekimin dhe masat parandaluese të tyre në kafshë;
25. Të përshkruajë shkaqet, shenjat klinike dhe mjekimin e plagëve të gjirit;
26. Të përshkruajë shkaqet, shenjat klinike, mënyrat e trajtimit dhe masat për parandalimin e sëmundjeve të kafshëve të porsalindura;
27. Të klasifikojë llojet e kafshëve sipas qëllimit;
28. Të shpjegojë rëndësinë e përmirësimit racor dhe seleksionimit të kafshëve për riprodhim, sipas drejtimit ekonomik;
29. Të shpjegojë rëndësinë e treguesve racorë të certifikatës gjenealogjike;
30. Të shpjegojë mënyrën e përlllogaritjes së pjellorisë në kafshë;
31. Të shpjegojë përparësitë e inseminimit artificial (IA) kundrejt atij natyral dhe metodat përkatëse të IA;
32. Të shpjegojë planifikimin e ciklit riprodhues të kafshës dhe përgatitjen e kalendarit të tij;
33. Të listojë instrumentet e inseminimit artificial sipas llojit të kafshëve;
34. Të përshkruajë mënyrën e vlerësimit të spermës nga ana vizuale dhe mikroskopike;
35. Të rendisë rregullat e marrjes, transportimit, ruajtjes dhe vlerësimit të spermës për inseminimin artificial në kafshë.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbulojë shenjat e afshit në kafshë me metoda të ndryshme;
2. Të zbatojë teknikat e inseminimit artificial, më kafshë;

3. Të kontrollojë barrsmërinë në kafshë me metoda të ndryshme;
4. Të asistojë në procesin e pjelljes në kafshë;
5. Të kujdeset për kafshët e porsalindura;
6. Të zbatojë metodat në rastet e pjelljeve të vështira në kafshë;
7. Të përkujdeset për kafshët me shenjat e prolapsit të vaginës dhe mitrës;
8. Të kryejë mjekimin dhe trajtimin e patologjive të organeve gjinore në kafshë të
9. ndryshme;
10. Të kryejë trajtimin e shterpësisë në kafshë;
11. Të mjekojë patologjitë e gjirit në kafshë;
12. Të trajtojë (përkujdesje, parandalim dhe mjekim) sëmundjet e kafshëve të porsalindura;
13. Të kryejë seleksionimin e kafshëve dhe përmirësimin racor të tyre;
14. Të kryejë inseminimit artificial (IA) në kafshë me metoda të ndryshme.

Kriteret e vlerësimit

- Përzgjedh kafshët për riprodhim sipas moshës dhe peshës trupore;
- Vrojton fazat e ciklit seksual tek kafshët sipas udhëzimeve përkatëse;
- Identifikon shenjat e afshit sipas llojit të kafshëve dhe metodave përkatëse;
- Administron preparate hormonale për nxitjen dhe sinkronizimin e ciklit seksual tek kafshët sipas standardeve përkatëse;
- Identifikon trupin e verdhë sipas procedurave përkatëse;
- Kryen inseminimin artificial tek kafshët sipas metodave përkatëse;
- Kryen kontrollin e barrsmërisë sipas metodave përkatëse;
- Identifikon shenjat paralajmëruese të pjelljes dhe fazat e saj, sipas specieve;
- Trajton kafshët pas pjelljes dhe të porsalindurit, sipas teknikave përkatëse;
- Zbaton teknikat e shumimit në shpendë dhe çeljen e zogjve në inkubator;
- Zbaton teknikat e rritjes dhe shumimit të krimbit të mëndafshit, bletës dhe peshqve;
- Dallon shenjat klinike në pjelljet e vështira sipas procedurave përkatëse;
- Kujdeset për shëndetin riprodhues të kafshëve duke zbatuar masat higjieno-sanitare;
- Trajton shterpësinë në kafshë sipas protokolleve përkatëse;
- Ndihmon në pjelljet e vështira tek kafshët sipas teknikave përkatëse;
- Kryen përgatitjen e vendit, kafshës dhe të mjeteve/instrumenteve për procesin e pjelljes;
- Kryen rregullimin e pozicionit të fetusit në pjelljet e vështira sipas rastit;
- Zbaton metodat e ndërhyrjes pa gjak në pjelljet e vështira në kafshë;
- Mbikëqyr shenjat e prolapsit të vaginës dhe mitrës në kafshë të ndryshme;
- Kryen mjekimin për prolapsin e vaginës dhe mitrës në kafshë të ndryshme sipas teknikave përkatëse;
- Kryen mjekimin dhe trajtimin e patologjive të organeve gjinore në kafshë të ndryshme sipas procedurave përkatëse;
- Kryen mjekimin e kafshëve me mbetje të shtratit sipas teknikave përkatëse;
- Mbikëqyr shenjat klinike për mastitet në kafshë të ndryshme sipas teknikave dhe procedurave përkatëse;
- Kryen mjekimin e kafshëve me mastit sipas procedurave përkatëse;

- Kryen mjekimin e kafshëve me plagë të gjirit sipas rastit;
- Mbikëqyr shenjat klinike të kafshëve të porsalindura sipas teknikave përkatëse;
- Kryen mjekimin e kafshëve të porsalindura sipas aparateve/sistemeve;
- Zbaton masat për parandalimin e sëmundjeve në kafshët e porsalindura sipas protokolleve përkatëse;
- Kryen seleksionimin e kafshëve për riprodhim sipas treguesve përkatëse;
- Kryen përmirësimin racor sipas treguesve përkatëse;
- Planifikon ciklin riprodhues të kafshës sipas moshës;
- Kryen inseminimin artificial (IA) sipas metodave përkatëse;
- Përdor instrumentet e inseminimit artificial sipas llojit të kafshëve;
- Vlerëson spermën sipas teknikave përkatëse;
- Zbaton rregullat e marrjes, transportimit, ruajtjes së spermës për inseminimin artificial në kafshë sipas procedurave përkatëse.

NjN-13-IV-0453-25 Kujdesi për të ushqyerit e kafshëve

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të klasifikojë ushqimet sipas prejardhjes (origjinës), përbërjes kimike, vlerës energjitike dhe përmbajtjes së lëndës së thatë;
2. Të rendisë ushqimet bazë në të ushqyerit e kafshëve sipas llojit dhe grup moshave;
3. Të argumentojë rëndësinë e vlerësimit të ushqimeve: etiketa, skadenca, kontaminimi nga myqet, ushqimet e kalbura, lëndët e huaja si dhe cilësitë organoleptike të tyre etj.;
4. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të nevojave ushqimore në kafshë;
5. Të shpjegojë rëndësinë e përshtatjes së të ushqyerit në gjendje patologjike në kafshë;
6. Të listojë zëvendësuesit e qumështit natyral tek të porsalindurit dhe mënyrat e përgatitjes së tyre.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë klasifikimin e ushqimeve të kafshëve sipas origjinës, përbërjes kimike, vlerës energjitike të tyre;
2. Të zbatojë listimin e ushqimeve në kafshë në varësi të specieve, kategorisë moshore si dhe gjendjes fiziologjike;
3. Të respektojë elementët vlerësues të ushqimit (etiketa, cilësitë organoleptike, lëndët e huaja etj.);
4. Të zbatojë dhënien e ushqimit në kafshë sipas situatave patologjike që ato kalojnë.

Kriteret e vlerësimit

- Kryen klasifikimin e ushqimeve sipas vlerave specifike të tyre, në mbështetje të shëndetit të kafshëve;
- Zbaton dhënien e ushqimit sipas specieve (gjedh, të imta, derra etj.);
- Zbaton dhënien e ushqimit sipas kategorisë moshore (kafshë të reja dhe të rritura);
- Zbaton dhënien e ushqimit sipas gjendjes fiziologjike (kafshë në laktacion, barrsmëri, etj.);
- Vlerëson elementët e ushqimit si etiketa, cilësitë organoleptike, praninë e mykut etj.;
- Respekton dhënien e ushqimit të diferencuar në kafshët me patologji (diarre,

- konstipacion etj.);
- Mbikëqyr të ushqyerit e kafshëve para dhe pas pjelljes, sipas teknikave përkatëse.

NjN-13-IV-0454-25 Kirurgjia profilaktike me procedura kirurgjikale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përkufizojë objektin e kirurgjisë veterinare;
2. Të klasifikojë llojet ndërhyrjeve të thjeshta kirurgjikale;
3. Të shpjegojë mënyrat dhe rëndësinë e ndërhyrjeve kirurgjikale profilaktike;
4. Të klasifikojë llojet e operacionit sipas qëllimit të tij;
5. Të rendisë materialet kirurgjikale dhe përdorimet e tyre;
6. Të përshkruajë metodat antiseptike, aseptike;
7. Të shpjegojë mënyrat e sterilizimit të mjeteve dhe instrumenteve kirurgjikale;
8. Të përshkruajë metodat e fiksimit të kafshëve të ndryshme;
9. Të përshkruajë mënyrën e përgatitjes së mjekut veteriner dhe kafshës para, gjatë dhe pas operacionit;
10. Të përshkruajë lëndët anestetike (lokale dhe të përgjithshme);
11. Të përshkruajë elementet e operacionit kirurgjikal;
12. Të klasifikojë llojet e lëndimeve (plagëve), shkaqet dhe mënyrat e mjekimit të tyre;
13. Të rendisë llojet e gjakderdhjeve dhe metodat e ndalimit të tyre;
14. Të përshkruajë teknikat e fashimit dhe llojet e drenazhit;
15. Të përshkruajë parimet dhe rregullat e qepjes së plagëve;
16. Të shpjegojë mënyrat e mjekimit të infeksioneve kirurgjikale (absese, fistula, flegmona, empiema etj.);
17. Të shpjegojë metodat për ndërhyrje emergjente dhe mjetet përkatëse;
18. Të përshkruajë llojet dhe mënyrat e injeksioneve;
19. Të shpjegojë konceptet e punksionit, salasit dhe transfuzionit;
20. Të shpjegojë rëndësinë e dhe metodat e kastrimit/sterilizimit, si dhe instrumentet përkatëse;
21. Të rendisë komplikacionet pas kastrimit/sterilizimit;
22. Të përshkruajë faktorët që ndikojnë mbi formën dhe cilësitë e thundrës;
23. Të përshkruajë teknikat dhe mënyrat e trajtimit të thundrës, prerjes së brirëve, bishtit, dhëmbëve dhe sqepit në kafshë.

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të asistojë/zbatojë teknikat për kastrimin/sterilizimin dhe komplikacionet e tij;
2. Të zbatojë teknikat e mirëmbajtjes/prerjes të thundrave, bishtit, dhëmbëve, sqepit dhe brirëve;
3. Të zbatojë procedurat për ndërhyrjet e thjeshta kirurgjikale;
4. Të zbatojë procedurat për mjekimin e plagëve në kafshë.

Kriteret e vlerësimit

- Planifikon kohën e realizimit të ndërhyrjeve kirurgjikale profilaktive në specie;
- Realizon në kohë planin e ndërhyrjeve kirurgjikale profilaktive;
- Asiston në kastrimin/sterilizimin me metoda të ndryshme dhe instrumentet përkatës;
- Ndërhyn në kohë në komplikacionet pas kastrimit/sterilizimit;

- Kryen mirëmbajtjen dhe prerje e thundrave, sipas teknikave përkatëse;
- Kryen prerjen e bishtit, sipas teknikave përkatëse;
- Kryen prerjen e brirëve, sipas teknikave përkatëse;
- Kryen mirëmbajtjen dhe prerjen e dhëmbëve në specie, sipas teknikave përkatëse;
- Kryen prerjen e sqepit, sipas teknikave përkatëse;
- Përdor materialet kirurgjikale sipas llojit të operacionit;
- Zbaton procedurat e asepsisë, sipas metodave përkatëse;
- Sterilizon mjetet dhe instrumentet kirurgjikale, sipas procedurave përkatëse;
- Fikson kafshët me metoda të ndryshme;
- Asiston mjekun veteriner para, gjatë dhe pas operacionit;
- Përgatit kafshën dhe fushën e operacionit para operacionit;
- Kujdeset për kafshën gjatë dhe pas operacionit;
- Përdor lëndët anestetike (lokale dhe të përgjithshme), sipas rekomandimeve të mjekut dhe udhëzimeve të përdorimit;
- Mjekon plagët e ndryshme lokale, sipas llojit të tyre;
- Kryen injeksione të ndryshme, sipas procedurave përkatëse;
- Përdor mjete dhe metoda për ndalimin e gjakderdhjes;
- Kryen fashimin sipas teknikave dhe rajoneve përkatëse;
- Kryen drenazhimin sipas teknikave dhe rajoneve përkatëse absese, fistula, flegmona, empiema etj.);
- Qep plagë të ndryshme sipas teknikave përkatëse;
- Kryen ndërhyrje emergjente me teknikat dhe mjetet përkatëse.

NjN-13-IV-0455-25 Administrimi i preparateve mjekësore veterinarë

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përkufizojë objektin e studimit të farmakologjisë;
2. Të përshkruajë rrugët e administrimit të barnave dhe veprimet e tyre në organizëm;
3. Të përshkruajë faktorët dhe kushtet që ndikojnë mbi efektin farmakologjik të barnave;
4. Të shpjegojë efektet anësore të barnave në organizëm nga përdorimi i tyre;
5. Të përshkruajë mënyrat e thjeshta të përgatitjes së barnave;
6. Të përkufizojë recetën mjekësore dhe elementët përbërës të saj;
7. Të listojë njësitë matëse farmakologjike;
8. Të përshkruajë trajtat e ndryshme farmaceutike (ngurta, buta, lëngëta);
9. Të përshkruajë veprimin e lëndëve farmaceutike, sipas sistemeve/aparateve në organizëm;
10. Të përshkruajë veprimin e substancave antimikrobike, antiinflamatore (steroide dhe josteroide), preparateve vitaminike e hormonale në praktikën veterinarë;
11. Të përshkruajë rëndësinë e ruajtjes dhe afatin e përdorimit të preparateve mjekësore veterinarë (PMV);
12. Të përshkruajë rëndësinë e kohës së pezullimit të PMV³-ve në produkte blegtorale.
13. Të përshkruajë elementët e regjistrit të preparateve mjekësore veterinarë.

³ Preparate Mjekësore Veterinarë

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë administrimin dhe/ose përgatitjen e barnave sipas recetës mjekësore;
2. Të zbatojë rregullat e ruajtjes, afatin e përdorimit të preparateve mjekësore veterinarë, sistemimin dhe kohën pezullimit të tyre në produkte blegtorale.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton me korrektësi recetën dhe rekomandimet sipas udhëzimeve të mjekut veteriner;
- Administron preparatet mjekësore veterinarë sipas udhëzuesve përkatës;
- Rendit preparatet mjekësore veterinarë sipas trajtave/formave farmaceutike;
- Sistemon barnat në farmaci sipas efekteve në aparate/sisteme të organizmit të kafshës;
- Kontrollon skadencën dhe ruajtjen e preparateve mjekësore veterinarë sipas kushteve teknike të kërkuara;
- Respekton afatin e përdorimit të preparateve mjekësore veterinarë sipas etiketave përkatëse;
- Plotëson me korrektësi regjistrin e përdorimit të preparateve mjekësore veterinarë sipas kërkesave dhe udhëzimeve të shërbimit veterinarë shtetërorë;
- Respekton kohën e pezullimit të preparateve mjekësore veterinarë në produkte blegtorale bazuar në etiketat përkatëse (udhëzime);
- Përgatit forma të thjeshta farmaceutike sipas procedurave përkatëse dhe njësisive matëse (doza);
- Kontrollon kafshën për efektet anësore të mundshme të barnave në organizëm;
- Përgatit barna të thjeshta sipas recetës mjekësore.

NjN-13-IV-0456-25 Kampionimi për analiza laboratorike dhe kërkim shkencor

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë llojet e mjeteve për kampionimin e mostrave biologjike sipas qëllimit të mbledhjes së tyre;
2. Të shpjegojë arsyet e marrjes së mostrave biologjike nga kafshët si dhe teknikat e kampionimit të tyre (organe të ndryshme, gjak, urinë, feçe, qumësht, vezë) nga basenet e ujit, kosheret e bletëve dhe ushqimet për kafshë;
3. Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes dhe transportit të kampionit të marrë;
4. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të protokolleve të biosigurisë gjatë marrjes së mostrave biologjike.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë teknikat e marrjes së mostrave biologjike dhe etiketimin e tyre, duke zbatuar protokollin e biosigurisë;
2. Të zbatojë mënyrën e ruajtjes dhe transportit të mostrave biologjike në laborator.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton me korrektësi teknikat e marrjes së kampioneve të gjakut në kafshë;
- Zbaton me korrektësi teknikat e marrjes së kampioneve të qumështit në kafshë;
- Zbaton me korrektësi teknikat e marrjes së kampioneve të urinës në kafshë;

- Zbaton me korrektësi teknikat e marrjes së kampioneve të feçes në kafshë;
- Zbaton me korrektësi teknikat e marrjes së kampioneve të lëkurës në kafshë;
- Zbaton me korrektësi teknikat e marrjes së kampioneve nga organet e brendshme;
- Zbaton me korrektësi teknikat e marrjes së materialit në traktin gjinor femëror/mashkullor, në kafshë;
- Zbaton me korrektësi tamponimin në organe të ndryshme;
- Zbaton me korrektësi teknikat e marrjes së mostrave nga basenet e ujit (ujit, sedimentit, peshqve);
- Zbaton me korrektësi teknikat e marrjes së mostrave nga kosheret e bletëve (mjalti, dylli, poleni, larvat);
- Zbaton me korrektësi teknikat e marrjes së mostrave në kafshët ekzotike;
- Zbaton me korrektësi teknikat e marrjes së mostrave të vezëve si dhe nga mjedisi ku mbahen vezët;
- Zbaton me korrektësi teknikat e marrjes së mostrave të ushqimeve për kafshë (foragjere, ushqime të lagështa, suplemente etj.);
- Zbaton protokollet e biosigurisë gjatë kampionimit;
- Përdor me korrektësi mjetet e kampionimit të mostrave (shiringa, gjilpëra, kateter, tampone, qese sterile, kontenitorë qumështi, kontenitorë urine, kontenitorë ushqimi, kuti vezësh etj.);
- Kryen etiketimin e mostrave biologjike të kafshëve, sipas protokollit;
- Menaxhon me korrektësi mostrat deri në dërgimin e tyre në laboratorin e analizave (llojin e kontenitorit ku vendosen mostrat, temperaturën e ruajtjes, kohën e dërgimit);
- Zbaton me korrektësi procedurën e ruajtjes dhe transportit të kampionit të marrë. □

NjN-13-IV-0457-25 Kontrolli i produkteve me origjinë shtazore

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit në fuqi për kontrollin e produkteve shtazore;
2. Të shpjegojë rreziqet e mundshme fizike, kimike dhe biologjike në zinxhirin produktiv dhe gjurmueshmërinë;
3. Të argumentojë rëndësinë e njohjes së certifikatës veterinarë të kafshëve kur ato mbërrijnë në thertore;
4. Të listojë karakteristikat organoleptike normale të ushqimeve me origjinë shtazore;
5. Të shpjegojë kushtet e transportit, ruajtjes dhe shitjes së ushqimeve me origjinë shtazore;
6. Të shpjegojë rrezikun e konsumit të produkteve ushqimore me prejardhje nga kafshët me sëmundje zoonotike;
7. Të shpjegojë mënyrën përdorimit të testeve të shpejta për identifikimin e problematikave lidhur me sigurinë e produkteve ushqimore;
8. Të shpjegojë mënyrat e prodhimit të ushqimeve me origjinë shtazore në kushte organike.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë legjislacionin në fuqi për kontrollin e produkteve me origjinë shtazore;
2. Të zbatojë klasifikimin e produkte me origjinë shtazore mbi bazën e karakteristikave organoleptike të tyre sipas legjislacionit në fuqi;
3. Të zbatojë kushtet e ruajtjes, transportit së produkteve me origjinë shtazore sipas legjislacionit në fuqi;
4. Të kryejë identifikimin dhe sinjalizimin e menjëhershëm të rreziqeve të mundshme gjatë zinxhirit produktiv;
5. Të menaxhojë mënyrat e prodhimit të produkteve organike.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton legjislacionin në fuqi për kontrollin e produkteve shtazore;
- Interpreton certifikatën veterinarë të kafshëve bazuar në elementët përbërës së saj;
- Vlerëson karakteristikat organoleptike normale të ushqimeve me origjinë shtazore;
- Mbikëqyr kushtet e transportit të ushqimeve me origjinë shtazore;
- Mbikëqyr të ushqyerit e kafshëve dhe prodhimin e ushqimeve me origjinë shtazore në kushte organike;
- Përdor testet e shpejta për identifikimin e problematikave lidhur me sigurinë e produkteve ushqimore;
- Kryen marrjen korrekte të kampioneve ushqimore, sipas planeve të kampionimit (plani me dy ose tri klasa).

NjN-23-IV-0005-24 Sipërmarrje dhe edukim karriere

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë parimet bazë të Kodit të Punës;
2. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit Tatimor në fuqi;
3. Të shpjegojë konceptet dhe llojet e dokumenteve financiare dhe ligjore;
4. Të shpjegojë mënyrat e plotësimit dhe arkivimit të dokumentacionit financiar;
5. Të argumentojë mënyrën dhe rëndësinë e informimit nga tregu për çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve, pajisjeve dhe instrumenteve etj.;
6. Të shpjegojë llojet e faturave dhe procedurat e plotësimit/gjenerimit të tyre;
7. Të shpjegojë format e blerjes së mjeteve, materialeve, instrumenteve, pajisjeve dhe produkteve;
8. Të shpjegojë mënyrat dhe elementët e llogaritjes së kostos së mjeteve, materialeve, pajisjeve, instrumenteve, pajisjeve etj.;
9. Të shpjegojë mënyrat e përgatitjes së një oferte;
10. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e kryerjes së inventarizimit për mjetet, materialet, pajisjet, produktet etj.;
11. Të identifikojë elementet e llogaritjes së çmimit përfundimtar për produktet/shërbimet e ofruara;
12. Të rendisë llojet e dokumenteve për marrjen/dorëzimin e produktit/shërbimit;
13. Të listojë komponentët e hartimit të një buxheti;
14. Të shpjegojë teknikat e marketingut;
15. Të shpjegojë mënyrat e hartimit të urdhrit të punës;

16. Të shpjegojë llojet e raportimeve financiare;
17. Të shpjegojë mënyrat e administrimit të regjistrit, kartelave mjekësore dhe dokumentacionit veterinar;
18. Të shpjegojë rëndësinë e zhvillimit të karrierës;
19. Të shpjegojë rëndësinë e vetëvlerësimit dhe identifikimit të nevojave për zhvillimin profesional;
20. Të shpjegojë metodat e zhvillimit të aftësive personale dhe profesionale;
21. Të shpjegojë rëndësinë e transmetimit të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja tek kolegët dhe bashkëpunëtorët;
22. Të shpjegojë rëndësinë e literaturës bashkëkohore dhe pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme (forume, konferenca, seminare, work-shop etj.).

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë kodin e punës dhe legjislacionin tatimor në fuqi;
2. Të kryejë veprime financiare;
3. Të zbatojë teknikat e marketingut për produktet/shërbimet e kryera;
4. Të monitorojë/zbatojë procedurat e zhvillimit profesional.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton me korrektësi legjislacionin tatimor, kodin e punës dhe legjislacionin lidhur me aktivitetin që kryen;
- Dokumenton punën e kryer, konsumimin e materialeve dhe urdhrat e punës sipas formateve përkatëse;
- Zbaton parimet bazë të Kodit të Punës;
- Plotëson dhe arkivon dokumentacionin financiar dhe raporte periodike për aktivitetet e zbatuara;
- Mbikëqyr regjistrimin e faturave të lëshuara klientëve dhe dokumentacionin veterinar, sipas procedurës përkatëse;
- Informohet periodikisht nga tregu për çmimet dhe cilësinë e mjeteve, materialeve, pajisjeve, instrumenteve dhe produkteve;
- Plotëson, gjeneron faturat financiare sipas procedurës përkatëse;
- Kryen blerjen e mjeteve, materialeve, pajisjeve, instrumenteve dhe produkteve;
- Llogarit saktë koston e mjeteve, materialeve, pajisjeve, instrumenteve, produkteve etj.;
- Përgatiti një ofertë për produktin/shërbimin e ofruar;
- Mbikëqyr kryerjen e inventarizimit për mjete, materiale, pajisje etj.;
- Llogarit saktë çmimin përfundimtar për produktin/ shërbimin e ofruar;
- Plotëson saktë dokumentacionin e marrjes/dorëzimit të produktit/shërbimit;
- Harton një buxhet të thjeshtë, sipas teknikave përkatëse;
- Zbaton teknikat e marketingut;
- Identifikon/përcakton nevojat për zhvillimin e aftësive personale dhe profesionale;
- Transmeton në kohë njohuritë dhe aplikimin e teknikave/teknologjive të reja;
- Merr pjesë rregullisht në trajnime, kurse, ëorkshope lidhur me veprimtarinë e punës;
- Studion vazhdimisht literaturën bashkëkohore.

NjN-22-IV-0006-24 Komunikimi dhe etika profesionale

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë parimet bazë të komunikimit;
2. Të shpjegojë parimet e etikës profesionale dhe zbatimin e Kodit të Etikës;
3. Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit verbal, joverbal, të shkruar dhe elektronike;
4. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale dhe dhënien e mesazhit të saktë dhe të qartë profesional;
5. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të komunikimit hierarkik;
6. Të përshkruajë teknikat e negocimit, menaxhimin e mosmarrëveshjeve dhe arritjes së dakordësisë mes palëve;
7. Të shpjegojë parimet e punës në grup;
8. Të shpjegojë rëndësinë e informimit/ndërgjegjësim të komunitetit lidhur me sëmundjet, vaksinimin, regjistrimin etj.;
9. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të TIK⁴ në komunikim;
10. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të parimeve të barazisë fetare, gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët;
11. Të shpjegojë mënyrat dhe rëndësinë e informimit mbi problemet dhe të rejat e ditës;
12. Të argumentojë rëndësinë e mënyrave të zgjidhjes së problemeve dhe mendimi kritik.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë parimet e etikës dhe terminologjinë profesionale në komunikim;
2. Të zbatojë teknologjitë bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit;
3. Të zbatojë parimet e punës në grup dhe komunikimit hierarkik.

Kriteret e vlerësimit

- Informohet për problemet dhe të rejat e ditës sipas detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara në planin e punës;
- Mbikëqyr/zbaton rregullat e komunikimit etik dhe profesional sipas Kodit të Etikës;
- Përdor terminologjinë profesionale në mjedisin e punës, sipas rregullores së brendshme;
- Merr dhe përcjell mesazhe të sakta dhe të qarta;
- Mbikëqyr/zbaton parimet e punës në grup;
- Zgjidh në kohë ankesat, mosmarrëveshjet në mjedisin e punës;
- Përdor teknologjitë bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit;
- Zbaton rregullat e komunikimit hierarkik, në vendin e punës;
- Siguron ruajtjen e konfidencialitetit në veprimtarinë profesionale sipas rregullores së brendshme;
- Informon komunitetin lidhur me sëmundjet, vaksinimin, regjistrimin etj.;
- Respekton barazinë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj, në komunikim sipas kodit të etikës.

⁴ Teknologji Informacioni dhe Komunikimi

NjN-13-IV-0458-25 Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në veterinari

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të Standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
2. Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të legjislacionit të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit;
3. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të manualeve të përdorimit të mjeteve mbrojtëse dhe pajisjeve dhe rëndësinë e koordinimit të punës në raste të mosfunksionimit të tyre;
4. Të shpjegojë procedurat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
5. Të shpjegojë zbatimin e protokolleve në raste të gjendjes së jashtëzakonshme;
6. Të shpjegojë planin e evakuimit në raste emergjence;
7. Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të sinjalistikës në mjedis dhe sigurisë së shëndetit në punë;
8. Të shpjegojë mënyrën e ruajtjes së sigurt dhe asgjësimit të kimikateve dhe PMV-ve;
9. Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të higjienës personale dhe të mjedisit;
10. Të shpjegojë mënyrën e menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme biologjike dhe mjekësore, ndarjes dhe depozitimit të tyre si dhe nevojën e mbajtjes së dokumentacionit për gjurmueshmërinë e tyre;
11. Të shpjegojë karakteristikat e një mjedisi të qëndrueshëm;
12. Të shpjegojë raportimin e shkeljeve mjedisore nga individë apo ferma.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të mbikëqyrë zbatimin e standardeve dhe legjislacionit në fuqi për rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit;
2. Të zbatojë manualin për përdorimit të mjeteve mbrojtëse dhe pajisjeve të punës si dhe rëndësinë e koordinimit të punës në raste të mosfunksionimit të tyre;
3. Të mbikëqyrë zbatimin e rregullave për mbrojtjen e mjedisit dhe depozitimin e mbetjeve organike nga aktiviteti i blegtorisë;
4. Të mbikëqyrë zbatimin e procedurave të dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti si dhe protokolleve në raste të gjendjes së jashtëzakonshme;
5. Të mbikëqyrë zbatimin e planit të evakuimit në raste emergjence;
6. Të mbikëqyrë respektimin të sinjalistikës në mjedis dhe sigurisë së shëndetit në punë;
7. Të mbikëqyrë ruajtjen dhe menaxhimin e sigurt të kimikateve dhe barnave;
8. Të mbikëqyrë zbatimin e higjienës personale dhe të mjedisit;
9. Të mbikëqyrë zbatimin e praktikave të qëndrueshme në fermat e kafshëve;
10. Të zbatojë raportimin e shkeljeve mjedisore nga individë apo ferma.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton Standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të rregullave të sigurimit teknik;
- Zbaton legjislacionin e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit;
- Zbaton manualin të përdorimit të mjeteve mbrojtëse dhe pajisjeve të sigurisë;

- Raporton për mosfunksionimin e mjeteve mbrojtëse dhe pajisjeve të sigurisë;
- Zbaton procedurat e dhënies së ndihmës së parë në rast aksidenti;
- Zbaton protokollet në raste të gjendjes së jashtëzakonshme;
- Respekton sinjalistikën në mjediset e punës sipas rregullit;
- Asiston në ruajtjen dhe asgjësimin e kimikateve dhe PMV-ve;
- Zbaton manualët përkatëse të higjienës personale dhe të mjedisit;
- Asiston në menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme biologjike dhe mjekësore;
- Raporton në kohë shkeljet mjedisore.
- Përdor me efikasitet burimet për një mjedisi të qëndrueshëm.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Planifikimi dhe organizimi i punës në veterinar	3	NjN-13-IV-0447-25
2	Bazat e anatomisë, fiziologjisë dhe patologjive në kafshë	14	NjN-13-IV-0448-25
3	Higjiena, shëndeti i kafshëve dhe mirëqenia e tyre	9	NjN-13-IV-0449-25
4	Mikroorganizmat, infeksioni, sëmundjet infektive dhe profilaksia e tyre	9	NjN-13-IV-0450-25
5	Sëmundjet e brendshme dhe diagnoza e tyre	9	NjN-13-IV-0451-25
6	Kujdesi për shëndetin riprodhues të kafshëve	9	NjN-13-IV-0452-25
7	Kujdesi për të ushqyerit e kafshëve	9	NjN-13-IV-0453-25
8	Kirurgjia profilaktike me procedura kirurgjikale	12	NjN-13-IV-0454-25
9	Administrimi i preparateve mjekësore veterinare	6	NjN-13-IV-0455-25
10	Kampionimi për analiza laboratorike dhe kërkim shkencor	4	NjN-13-IV-0456-25
11	Kontrolli i produkteve me origjinë shtazore	7	NjN-13-IV-0457-25
12	Sipërmarrje dhe edukim karriere	3	NjN-23-IV-0005-24
13	Komunikimi dhe etika profesionale	3	NjN-22-IV-0006-24
14	Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në veterinar	3	NjN-13-IV-0458-25
	Total	100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e

arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kriterëve të caktuar.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar. Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit. Individit i lind e drejta të certifikohet për njësitë e të nxënit specifik, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftoheshin nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikant profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **N-IV-25**

N – Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit

IV – Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **NjN-13-IV-0447-25**

NjN – Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

13 – Numri që identifikon orientimin e Njësive të të Nxënit

IV – Shifra që tregon nivelin e Njësive të të Nxënit në strukturën e KSHK

0447 – Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit